



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE**



Tiranë , më 04/ 01 / 2019

**Shtojce:**

Për shtyrjen e afatit të hapjes së ofertave në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: **“Ndërtim rrjet ujësjellësi në zonën Kodër Babrru, në Rrugët: "Sali Vranishti, Prengaj, Xhorxhi Martini, 1 Maj, 28 Nëntori”.**

Të nderuar operatorë ekonomikë!

Pranë Autoritetit Kontraktor UKT sha është paraqitur ankesë nga një operator ekonomik me datë 22.12.2018 në lidhje me dokumentat e tenderit për procedurën e prokurimit me objekt: **“Ndërtim rrjet ujësjellësi në zonën Kodër Babrru, në Rrugët: "Sali Vranishti, Prengaj, Xhorxhi Martini, 1 Maj, 28 Nëntori”.** Nga ana e Autoritetit Kontraktor u morën të gjitha masat për pezullimin e kësaj procedure si edhe për shqyrtimin e kësaj ankesë duke i kthyer përgjigje operatorëve ekonomik në datë 24.12.2018. Autoriteti Kontraktor në mbështetje të Ligjit të prokurimit Nr 9643 dt 20.11.2006 neni 63 pika 1.1 si edhe VKM Nr 914 dt 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 78 pika 4 respektoi të drejtën e operatorit ekonomik për të ushtruar të drejtën e tyre për ankimim pranë Komisionit të Prokurimit Publik si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave për prokurimet publike .

Autoriteti Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Sha Tiranë pas përfundimit të afateve të ankimimit në mbështetje të VKM Nr 914 dt 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 78 pika 6 gërma (d) vendosi të zgjatë afatin kohor të procedurës së prokurimit për të gjithë periudhën që procedura ka qënë e pezulluar.

Autoriteti Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Sha Tiranë pasi ka marë në shqyrtim ankesë nga një operator ekonomik ne Mbështetje të Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) Kreu V neni 42 pika 2, si dhe në VKM-në Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VII neni 62, bën modifikimin e dokumentave standarte te tenderit me objekt: **“Ndërtim rrjet ujësjellësi në zonën Kodër Babrru, në Rrugët: "Sali Vranishti, Prengaj, Xhorxhi Martini, 1 Maj, 28 Nëntori”.** me Fond Limit: **17.349.160** (shtatëmbëdhjetë milion e treqind e dyzetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, si më poshtë vijon:

Nisur nga sa më sipër sqarojmë se Hapja e ofertave do të jetë si më poshtë vijon:

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

**Data: 31/01/2019 (dd/mm/vvvv) Ora: 09:00**

**Vendi:** [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al), UKT sha, Tiranë

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)**

**Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

**Data:** 31/01/2019 (dd/mm/vvvv) **Ora:** 09:00

**Vendi:** [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al), UKT sha, Tiranë

